



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:081863

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05828803

Ac.nr.6112/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku- kryetari i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditëses A.K nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.S nga Gjilani, kundër të paditurës Q.K.M.P në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.R-B, juriste tek e paditura, për kompensimin e pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.575/21, të datës 17.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Q.K.M.P në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.575/21, të datës 17.06.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.575/21, të datës 17.06.2022, ka vendosur si vijon: I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses A.K nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Q.K.M.P në Gjakovë, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës, t'ia paguaj shumën prej 1,529.00 (një mijë e pesëqind e njëzetë e nëntë euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 26.04.2021, e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269,20 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e njëzetë cent), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi e autorizuar e të paditurës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës, të hedhe poshtë aktgjykimin e atakuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësja përmes të autorizuarit të saj, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet si dhe të detyrohet e paditura që ti paguajë shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 26.04.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e pagave jubilarë, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën prej 1,529.00Euro, për dy paga jubilarë, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.575/21, të datës 17.06.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: nga kontrata e punës, me nr. prot. ..., datë 01.01.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësja ka lidhur kontratë pune me të paditurin I.M.P – Gjakovë, në detyrat e punës: Doktor Specialist – Shef i L.B.H, me kohëzgjatje të kontratës 01.01.2013. Nga vërtetimi i përvojës së punës, datë 26.01.2021, i lëshuar nga Q.K.M.P në Gjakovë, është provuar rrethana se paditësja është e punësuar në institucionin e lartcekur dhe ka 21 vite përvojë pune. Nga lista e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 01.03.2021 – 31.03.2021, vërtetohet se këtu paditësja ka 20 vjet përvojë pune dhe realizon pagë bazë mujore në lartësi prej 802.00 euro. Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 17 par.3, pika 3.2, dhe par.4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018. Vendimin mbi kamatën gjykata e shkallës së parë e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ngase nuk ka qenë kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se e njëjta ka përvojë pune mbi 20 vite, fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi i datës 26.01.2021 i lëshuar nga e paditura. Nga lista e pagave e lëshuar nga buxheti i RKS-së për paditësen, gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta realizon pagë mujore bazë në shumë prej 802.00 Euro.

Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se: Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “ *Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe*

b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “ Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”. Me nenin 17 paragrafi 3, të Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë të datës 11.06.2018 përcaktohet se: “ Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij, 3.2. për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij, 3.3. për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij ”, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni, përcaktohet se: “ Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf ”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, të lidhur dhe nënshkruar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSHSK-së) dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes të së drejtës për të parashtruar kërkesën për kompensimin e shpërblimit jubilar, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko-civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shpërblimit jubilar, për arsye se me nenin 245 paragrafin 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6112/22, me datë 14.06.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v